

GEOXE 50 WG

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



“KUJDES”

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Fungicid kontakti për kontrollin e sëmundjeve të ndryshme kërpudhore.

Përmbajtja: Fludioxonil 50%.

Formulimi: Granula të tretshme në ujë (WG).

Masat parambrojtëse:

- Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve;
- Mos hani e mos pini lëngje ose duhan gjatë përdorimit;
- Shmangni thithjen e mjegullës spërkatëse;
- Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mjete mbrojtëse personale për mbrojtjen e syve dhe fytyrë;
- Lani rrobat e ndotura para ripërdorimit;
- Punëtorët nuk duhet të hyjnë në parcelën e trajtuar para se të thahet plotësisht tretësira spërkatëse në sipërfaqen e gjetheve;
- Punëtorët duhet të veshin veshje dhe doreza të përshtatshme mbrojtëse nëse hyjnë në fushë menjëherë pas spërkatjes;
- Mblidhni sasinë e derdhur;
- Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me ligjin kombëtar.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast aksidenti ose nëse nuk ndjeheni mirë, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore (tregoni etiketën kur është e mundur);
- Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Mbajeni të ngrohtë dhe të çlodhur;
- Nëse frymëmarrja nuk kthehet, bëni frymëmarrje artificiale. Thirrni menjëherë mjekun;
- Në rast kontakti me lëkurën: Lajeni me shumë ujë dhe sapun. Nëse shfaqet acarim ose skuqje e lëkurës: Këshillohuni/vizitoni me një mjek;
- Në rast kontakti me sytë: I shpëlani mirë ato me ujë të pastër e të bollshëm për të paktën 15 minuta. Kërkoni këshillë mjekësore nëse është e nevojshme;
- Në rast gëlltitje: Mos shkaktoni të vjella. Thirrni menjëherë mjekun dhe tregojini atij etiketën ose paketimin e produktit,
- ANTIDOTI: Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik.

PËRDORIMI:

Mollë, dardhë: Për kontrollin e stemfiliumit (*Stemphylium sp.*), alternaries (*Alternaria sp.*), gloeosporiumit (*Gloeosporium sp.*, *Penicillium sp.*), kalbëzimit të hirtë (*Botrytis cinerea*): 450 gr/ha (max) ose 30 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 1500 lit/ha. Për kontrollin e sëmundjeve gjatë ruajtjes (magazinimit) me trajtime para vjeljes Trajtime nga faza kur diametri i frutave është 4 cm (madhësia sa fruti i arrës) deri në fazën para vjeljes (BBCH 74-87). Deri në 2 trajtime me interval 7 ditor nëse kërkohet.

Hardhi (rush për tavolinë dhe për industri): Për kontrollin e kalbëzimit të hirtë (*Botrytis cinerea*): 1 kg/ha (max) ose 100 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 1000 lit/ha. Trajtime nga faza ku 70 % e kapelëzave të frutave janë rrëzuar, deri në fund të lulëzimit dhe gjatë pjekjes (BBCH 67-85). Deri në 2 trajtime me interval 21 ditor.

Kivi: Për kontrollin e alternaries (*Alternaria passiflora*), kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*), Stemfiliumit (*Stemphylium botryosum*, *Penicillium sp.*): 450 gr/ha (max). Sasia e tretësirës spërkatëse: 450-1500 lit/ha. Nga faza kur frutat kanë arritur në 30 % të madhësisë së tyre deri në pjekjen e plotë të frutave (BBCH 73-89). Deri në 2 trajtime me interval 19-21 ditor.

Luleshtrydhe (FH/S): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*): 500 gr/ha (max). Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1000 lit/ha. Nga fillimi i lulëzimit deri në vjeljen e dorës së dytë kur shumica e frutave kanë marrë ngjyrën tipike (BBCH 61-89). Deri në 2 trajtime me interval 10 ditor.

Domate (S): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*): 500 gram/ha (max) ose 50 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga shfaqja e lulës së 1^{re} në lulerinë e 3^{te} lulor deri në pjekjen e plotë të gjithë frutave (BBCH 67- 89). Deri në 2 trajtime me interval 7 ditor.

Spec (S): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*): 500 gr/ha (max) ose 50 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga shfaqja e sythit të 6^{te} lulor deri në pjekjen e plotë të gjithë frutave (BBCH 56-89). Deri në 2 trajtime me interval 7 ditor.

Kastravec (S), kungull (S): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*): 500 gr/ha (max) ose 50 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga fillimi i lulëzimit deri në fazën ku 9 ose më shumë fruta të kenë arritur madhësinë dhe formën tipike (BBCH 61-79). Deri në 2 trajtime me interval 7 ditor.

Bizele (FH) (e njomë & kokërr): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*), Sklerotinis (*Sclerotinia sp.*): 750 gr/ha (max) ose 90 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 800 lit/ha. Nga dalja e sythave të parë lulore deri sa bishtajat të arrijnë tyre tipike dhe kokrra është formuar plotësisht (BBCH 51- 79). Deri në 2 trajtime me interval 10 ditor.

Fasule (FH) (e njomë): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*), Sklerotinis (*Sclerotinia sp.*): 750 gr/ha (max) ose 90 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 800 lit/ha. Nga dalja e sythave të parë lulore deri sa bishtajat të arrijnë tyre tipike (BBCH 51-79). Deri në 2 trajtime me interval 10 ditor.

Marule (FH/S), sallatë (FH/S), rukol (FH/S), çikore (FH/S), endivie (FH/S), spinaq (FH/S), bimë aromatike (FH/S): Për kontrollin e kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*), Sklerotinis (*Sclerotinia sp.*): 500 gr/ha (max) ose 50 gr/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 1000 lit/ha. Nga dalja e gjethit të parë deri sa të arrijë madhësinë dhe formën e saj tipike (BBCH 11-49). Deri në 2 trajtime me interval 10 ditor.

Shegë: Për kontrollin pas mbledhjes sëmundjet: *Penicilium digitatum*, *Penicillium Italicum*, *Botrytis spp.*, *Rhizopus nigricans*, *Colletotrichum gloeosporioides*: 95-135 gr/100 lit, 3-4,5 lit përgatitje/ton fruta. Trajtim parandalues duke i lagur frutat me spërkatje pas vjeljes ose duke i lënë frutat në ujë për 30 sekonda. Spërkatni frutat pasi t'i keni larë (BBCH 99)

Mënyra e veprimit: Lënda vepruese fludioxonil i përket grupit kimik phenylpyrrole dhe vepron duke penguar veprimin e enzimës proteine kinase e cila katalizon sintezën e glicerinës duke shkaktuar dëme të pakthyeshme në membranat e qelizave kërpudhore.

Mënyra e përdorimit: Me spërkatje gjethore.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi ne mjedis:

Mos ndotni ujin me preparatin ose me ambalazhin e tij. Për të mbrojtur organizmat ujorë, lini një zonë mbrojtëse prej 10 metrash nga ujrat sipërfaqësore për hardhinë dhe 15 metrash për pemët frutore farore e kivin . Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe duke vazhduar përzierjen shtoni dozën e produktit. Plotësoni me sasinë tjetër të ujit duke vazhduar përzierjen. Tretësira spërkatëse mund të përdoret brenda disa orësh nga përgatitja e tij pasi ta përziejmë fuqishëm.

Pastrimi i makinave të spërkatjes: Menjëherë pas përdorimit, pastroni pajisjet spërkatëse. Ripastroni pajisjet spërkatëse 3 herë, nga të gjitha mbeturinat, duke e shpëlarë me ujë të pastër dhe duke derdhur ujin e shpëlarjes në enën e spërkatjes.

Vretje per perdorimin:

Mos rritni dozat. Për të parandaluar zhvillimin e rezistencës, trajtimet me GEOXE 50 WG duhet të alternohen me fungicide nga grupe të tjera me mënyra të ndryshme veprimi nga ato të phenylpyrroleve.

Në domate, kastravec, kungull i njomë, fasule, bizele, marule, sallatë, rukol, cikore, endivie, dhe spinaq, GEOXE 50 WG mund të përdoret në alternim me PMB të tjera me mënyra të ndryshme veprimi ose në bllok max 2 trajtime me GEOXE 50 WG që ndiqet nga trajtimi me fungicid me mënyrë tjetër veprimi.

Në kulturat bujqësore të aprovuara lejohen deri në 2 trajtime me GEOXE 50 WG për çdo periudhë kultivimi,

duke respektuar intervalin përkatës të trajtimeve.

Kur nevojiten vetëm 2 trajtime në sezonin e rritjes, këshillohet të bëni vetëm 1 trajtim me GEOXE 50 WG. Trajtimet duhet të bëhen në fazat e hershme të zhvillimit të sëmundjes dhe të shmangni trajtimet shëruese. Për të mbrojtur ujërat nëntokësorë, mos e përdorni në zona me reshje të larta, në toka ranore dhe në ato me përmbajtje të ulët lënde organike.

Udhëzime për tërheqjen e sigurt të produktit dhe paketimit: Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëlarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

Karenca:

Mollë, dardhë, luleshtrydhe (S/FH), domate (S), spec (S), kastravec (S), kungull (S): 3 ditë. Rrush për tavolinë, kivi, marule (FH/S), sallatë (FH/S), rukol (FH/S), cikore (FH/S), endivie (FH/S), spinaq (FH/S), bizele (FH) (e njomë & kokërr), fasule (FH) (e njomë): 14 ditë. Rrush për industrinë: 21 ditë.

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi:

Në paketimin e tij origjinal të mbyllur, larg diellit dhe lagështisë, në një mjedis të ajrosur mirë, mbetet i qëndrueshëm për 2 vjet. Të mos ruhet në temperatura mbi 35° C.

Numri dhe data e regjistrimit: 758; date 18.2.2021;

Sasinë neto të PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: Deri në 1 kg;

Numrin e serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 2 vjet;

Llojin e ambalazhit bazë: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia, Shishe COEX ose HDPE;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland; Emri dhe adresa e aplikantit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland.